

# U vendosën marrëdhëniet diplomatike Shqipëri-Izrael

Me 19.8.1991 u nënshkrua në Jerusalemin, nga Ministria e Punëve të Jashtme, Memorandumi i Mirkuptimit për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Republikës së Shqipërisë dhe Shtetit të Izraelit, nga ministrat e jashtëm Kapllani e Levi.

Ministri Kapllani ndër të tjera tha se vendosja e marrëdhënieve diplomatike mbush një boshllëk të një kapitulli dhe hap një kapitull të ri.

Ministri Levi ndër të tjera tha se ndjehemi krenarë e të privilegjuar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë pasi Shqipëria e ka njohur Izraelin si shtet. Ju kemi mbrojtur gjithë jetën e Shqipërisë dhe për këtë jemi mirënjohës.

Ministri Levi tha gjithashtu se Qeveria e Izraelit akordon bursa për studentë shqiptarë për studime në degë të ndryshme në Izrael.

Zoti Kapllani ftoi ministrin e Jashtëm të Shtetit të Izraelit për një vizitë në Shqipëri.

Po dje, kryeministri i Shtetit të Izraelit, Shamir priti Muhamet Kapllanin i cili vlerësoi vizitën e ministrit tonë në Izrael si e para vizitë e një zyrtari të lartë shqiptar dhe ndër të tjera theksoi: «Ju kemi shumë veshtrësi ekonomike tani, por në rradhë të parë me punën e popullit tuaj si dhe me ndihmën e vendeve miq ju do t'i kapërceni këto situata. Ne i kuptojmë veshtrësitë tuaja dhe Brenda mundësive tona do t'ju ndihmojmë».

(Sipas ATSH-së)